



23 mars 2017

## SQARIM

### **Agjencia Kosovare e Privatizimit demanton lajmin e publikuar në gazetën ditore “Koha Ditore” të datës 22 mars 2017, me titull: “Moratorium” i ri për “Trepçën”**

**Prishtinë** - Agjencia Kosovare e Privatizimit dëshiron të sqaroj opinionin publik se është i pasaktë lajmi i publikuar në të përditshmen “Koha Ditore” të datës 22 mars 2017, me titull: bombastik “Moratoriumi” i Ri për “Trepçën”.

Është e çuditshme se si gazetari ka nxjerr një lajm të tillë “Moratoriumi” i Ri për “Trepçën”, edhe përkudër përgjigjeve që AKP i ka dërguar gazetës Koha Ditore, ku është thënë se nuk ka Moratorium e as Memorandum për Trepçën.

Fillimisht do t’i referohemi gjenezës së këtij titulli, duke i cituar pyetjet e dërguara nga gazetari i Kohës, por edhe përgjigjet zyrtare në to, të dërguara nga AKP.

Pyetja është parashtruar në mënyrë orientuese për “memorandum”: *“Cila është përmbajtja e memorandumit të mirëkuptimit të mbërritur me Qeverinë, që e adreson këtë çështje?”*. AKP në këtë pyetje është përgjigjur shkurt dhe qartë: *“Nuk ka memorandum të mirëkuptimit në mes Qeverisë dhe AKP-së për këtë çështje”*.

Nuk duam të merremi me shkaqet se si dhe pse këto përgjigje janë shtrembëruar, as të gjejmë shkakun e transformimit nga memorandum në moratorium, por jemi për atë që opinionin të jetë saktë i informuar! Andaj edhe një herë e përsërisim: *“Nuk ka memorandum të mirëkuptimit në mes Qeverisë dhe AKP-së për këtë çështje”*.

Do të ishte e tepërt të jepen shpjegime të tjera për përzierjen e memorandumit me moratoriumin, pasi që dallimet janë të mëdha.

Por, informimi i shtrembëruar nuk ndalet këtu. Në artikull thuhet tutje se: *“Trepça”, si e tërë, ndodhet nën menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), ani se prej gjysmë viti, nëpërmjet një ligji, Qeveria është bërë aksionare kryesore e tri aseteve thelbësore të kësaj ndërmarrjeje*.

AKP sqaron se që nga hyrja e Ligjit të ri për Trepçën, për sa i përket njësive aktive të Trepçës - minierave e flotacioneve, AKP është zhveshur nga të gjitha kompetencat, të cilat i ka pas të përshkruara me Ligjin e kaluar. Miratimet që konform Ligjit të Riorganizimit i ka lëshuar AKP



për shitjen e Koncentratit, nuk janë lëshuar që nga tetori i vitit të kaluar. Administrimi i kërkesës për miratim të pagave, i cili është përcjell nga AKP në cilësinë e Administratorit të ndërmarrjes në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk është bërë më që nga hyrja e Ligjit të ri në fuqi. Asnjë kërkesë e çfarëdo natyre si dhënie me qira, blerje etj., nuk është proceduar më për t'u shqyrtuar në Bord që nga iniciimi i Ligjit të ri për Trepçën, duke u munduar kështu që Trepça sh.a. të mos përcillet me obligime kontraktuale tek pronari i ri.

E vetmja gjë që e lidh AKP-në me Trepça sh.a. është zhvillimi i studimit të fizibilitetit, i cili është duke ndodhur aktualisht.

**FUND**